

# Magna Karta e Universitetit

## Parathënie

Të poshtëshënuarit Rektorë të Universiteteve u mbledhën në Bolonjë për nëntëqind vjetorin e Universitetit më të vjetër të Europës, katër vjet para heqjes përfundimtare të kufijve midis shteteve të Komunitetit Europian; duke parë përpara drejt një bashkëpunimi më të madh midis të gjitha vendeve europiane dhe duke besuar se shtetet duhet të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për rolin që Universitetet do të duhet të luajnë në një shoqëri gjithnjë e më ndërkombëtare,

konsiderojnë

1. se me afrimin e këtij mijëvjecari e ardhmja e njerëzimit varet në një shkallë të madhe nga zhvillimi kulturor, shkencor dhe teknologjik; dhe se kjo ndërtohet në qendrat e kultures, dijes dhe kërkimit që përfaqësohen nga universitetet e vërtetë;
2. se detyra e universiteteve për të shpërndarë njohuri në gjeneratat e reja, nënkupton se në botën e sotme, ata duhet t'i shërbejnë shoqërisë në tërësi; dhe se e ardhmja kulturore, shoqërore dhe ekonomike e shoqërisë kërkon vecanërisht një investim të konsiderueshëm në vazhdimin e edukimit.
3. se universitetet duhet t'i japin gjeneratave të ardhme arsim dhe trainim që do t'i mesojë ata, dhe nëpërmjet tyre të tjeret, të respektojnë harmonitë e medha të mjedisit natyror dhe të vete jetës. Të poshtëshënuarit Rektorë të Universiteteve Europiane shpallin për të gjitha shtetet dhe ndërgjegjen e të gjithë kombeve, parimet themelore, të cilat duhet që tani dhe kurdoherë të mbeshtesin punën e universiteteve.

## Parimet themelore

1. Universiteti është një institucion autonom në zemër të shoqërive i organizuar në mënyra të ndryshme për shkak të gjeografisë dhe trashëgimisë historike; ai prodhon, shqyrton, vlerëson dhe transferon kulturë nëpërmjet punës kërkimore dhe mësimdhënies. Për të përmbushur nevojat e botës rreth tij, puna e tij kërkimore dhe mësimdhënëse duhet të jetë moralisht dhe intelektualisht e pavarur nga i gjithë autoriteti politik dhe pushteti ekonomik.
2. Mësimdhënia dhe puna kërkimore në universitete duhet të jetë e pandarë me qëllim që mësimi të mos mbetet pas nevojave në ndryshim, kërkesave të shoqërisë dhe përparimit të njohurive shkencore.
3. Liria në kërkim dhe trainim është parimi themelor i jetës universitare; qeveritë dhe universitetet, për aq sa varet prej tyre, duhet të sigurojnë respektimin e kësaj kërkesë themelore. Duke refuzuar jo-tolerancën dhe duke qënë i hapur ndaj dialogut, universiteti është vendi ideal i mbledhjeve për ata mësimdhënës që janë të aftë t'i transmetojnë njohuritë e tyre, dhe kanë pajisjet e nevojshme për ti zhvilluar ato nëpërmjet kërkimit dhe novacionit dhe studentëve që janë të aftë dhe dëshirojnë t'i pasurojnë mendjet e tyre me këto njohuri.
4. një universitet është tutori i traditës humaniste Europiane, kujdesi i tij konstant është sigurimi i njohurive universale për të përmbushur detyrën e tij, ai kapërcen kufijtë gjeografike dhe politike, dhe afirmon nevojën vitale që kultura të ndryshme të njohin dhe influencojnë njëra tjetrën.

## Mjetet

Realizimi i këtyre objektivave nëpërmjet ndjekjes së këtyre parimeve, kërkon mjete efektive, të përshtatshme për kushtet aktuale.

1. Që të ruhet liria në kërkim dhe mësimdhënie, instrumentat e përshtatshëm për të realizuar këtë liri duhet t'u vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve të komunitetit universitar.

**2.** Rekrutimi i mësueve dhe rregullimi i statusit të tyre t'i nënshtrohet parimit se kërkimi është i pandarë nga mësimdhënia.

**3.** Cdo universitet duhet që – duke bërë lëshimet e përshtatshme sipas rrethanave - të sigurojë se liritë e studentëve janë të mbrojtura, dhe ata gëzojnë kushte që mund të marrin kulturën dhe trainimin të cilat kane si qëllim të tyre t'i zoterojnë.

**4.** Universitetet – vecanërisht në Europë – e konsiderojnë shkëmbimin e ndërsjelltë të informacionit dhe dokumentacionit, dhe projektet e shpeshta të përbashkëta për përparimin e të mësuarit, si thelbësore për progresin e qëndrueshëm të njohurive

Ashtu si në vitet më të hershme të historisë së tyre, ata inkurajojnë lëvizshmërinë midis nxënësve dhe studentëve; më tej, ata konsiderojnë një politikë të përgjithshme të statusit, titujve, provimeve ekuivalente (pa paragjykim për diplomat kombëtare) dhe dhënien e bursave si esenciale për realizimin e misionit të tyre në kushtet që mbizotërojnë sot.

Rektorët e poshtëshënuar, në emër të Universiteteve të tyre, angazhohen të bëjnë cdo gjë brenda fuqive të tyre për të inkurajuar cdo vend, si dhe organizatat ndërkombetare të angazhuara, për ti përpunuar politikat e tyre seriozisht sipas kësaj Magna Karte, e cila shpreh dëshirën unanime të universiteteve të vendosur dhe deklaruar lirisht.

*Bolonjë, 18 Shtator 1988.*

**Perkthyer nga: Entela Lako  
Perkthimi u mundësua nga SEE ECN.**